



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT SHKODER

Nr.296/1prot.

Shkodër, më/14.04.2023

LËNDA: Mbi vendimin Nr.27, datë 29.03.2023 të Këshillit të Bashkisë Vau-Dejës.

KËSHILLI BASHKIAK VAU-DEJËS

Prefekti i Qarkut Shkodër në zbatim të kompetencave që i jep ligji nr.107/2016 dt.2.10.2016 “Për Prefektin”, Urdhërit të Kryeministrit Nr.50, datë 12.04.2017 “Për miratimin e detyrave të administratës së Prefektit të Qarkut”, Urdhërit të Ministrit të Brendshëm Nr.175 dt.9.07.2020 “Për miratimin e rregullores së Brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut” si dhe aneksi 1 “Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollit nga Prefekti i Qarkut”, Kreu II, neni 4, në mbështetje të nenit 9, pika 1/1.2 germa a dhe c, neni 54/e.1, neni 55/3, neni 64/c të Ligjit Nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, VKM Nr.1423 datë 10.10.2008 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkise Vau-Dejës të Qarkut të Shkodrës”, VKM Nr.246 datë 31.03.2011 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.68 date.28.01.2008, për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Bushat të Qarkut të Shkodrës”, VKM Nr.54 datë 5.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve të procedurës e të mënyrës së dhënies me qera, enfiteoze apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” i ndryshuar, Udhëzimit Nr.13 datë 18.04.2018 për zbatim të VKM Nr.54, datë 5.02.2014”, shkresës së sekretarit të KB Vau-Dejës Nr.2393prot, datë 4.04.2023, shqyrtoi **VKB Vau-Dejës Nr.27 datë 29.03.2023** “Për dhënie pëlqimi në parim për dhënie në përdorim me anë të konkurrimit me afat deri në 10 vjet, të sipërfaqes prej 2590 m2, e llojit “Pa fryt”, pjesë e pasurisë Nr.546/4, ZK Nr.3506, fshati Stajkë, NJAD Bushat dhe pasurisë nr.357/2, ZK 3334, fshati Shelqet Bashkia Vau-Dejës, me qëllim për ushtrim aktiviteti në fushën e bujqësisë, blegtorisë dhe agropërpunimit”.

Për trajtim të mëtejshëm në zbatim të Urdhërit të Ministrit të Brendshëm Nr.175 datë 9.07.2020 “Për miratimin e rregullores së Brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut” si dhe aneksi 1 “Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollit nga Prefekti i Qarkut”, Kreu II, neni 4 kërkohet të plotësohet praktika me dokumentacionin e plotë mbi çertifikimin e pronës (çertifikatë pronësie ose në mungesë të saj statusi juridik i pronës) për pasurinë Nr.357/2, ZK Nr.3334, fshati Shelqet, Bashkia Vau Dejës, ndërsa për pasurinë Nr.546/4, ZK Nr.3506, fshati Stajkë, NJAD Bushat ju lejohet procedim të mëtejshëm duke ndjekur procedurat e konkurrimit publik (niveli i investimit, i punësimit & ofertën e detyrimit mujor të qerasë).

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

P R E F E K T I

Majlinda ANGONI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJES

KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr 27 Datë 29.03.2023

Dhënie pëlqimi në parim, për dhënie në përdorim me anë të konkurimit me afat deri 10 vjet, të sipërfaqes prej 2590 m², e llojit “Pa fryt”, pjesë e pasurisë nr 546/4 , Zk nr 3506, fshati Stajkë, dhe pasurisë nr 357/2, Zk nr 3334, fshati Shelqet, Bashkia Vau Dejës.

Bazuar në nenin 8, pika 2, neni 9 pika 1/1, 2, neni 18, neni 54 shkronja “e/1” (ndryshuar), neni 55 pika 4, të ligjit nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, ligji nr 38/2019, ligji nr 8743, datë 22.02.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, ligji nr. 8744 datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njesitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar, në VKM nr 246, dt 31.03.2011, “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr 68, dt 28.01.2008, për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Bushat të Qarkut të Shkodrës”, në VKM nr 1423, datë 10.10.2008, “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme, publike të shtetit që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Vau Dejës të Qarkut të Shkodrës”, në VKM nr 54, datë 05.02.2014, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar, Udhëzimin nr 13, datë 18.04.2018, “Për zbatimin e VKM-së nr 54, datë 05.02.2014” (sipërcituar), si dhe pas shqyrtimit të projekt vendimit nr 12, datë 20.02.2023, paraqitur nga Drejtoria Juridike e Prokurimeve dhe Integritimit, pas diskutimit dhe miratimit me shumicë të votave, Këshilli

VENDOSI :

1. Miratimin në parim të dhënies me qira me anë të konkurimit me afat deri 10 vjet, të sipërfaqes prej 2590 m², e llojit “Pa fryt”, pjesë e pasurisë nr 546/4, Zk nr 3506, fshati Stajkë, dhe pasurisë nr 357/2, Zk nr 3334, fshati Shelqet, Bashkia Vau Dejës, e cila mund të përdoret për aktivitete në fushën e bujqësisë, blegtorisë dhe agropërpunimit.
2. Për zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet Drejtoria Juridike e Prokurimeve dhe Integritimit.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes Publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.)

KRYETAR I KËSHILLIT

Mark Bisha

Miratuar me 19 vota

Vota pro 19

Vota kundër -

Vota abstenim -

Zbardhur me datë 03-04-2023

Adresa: “Rruga Qafa e Gurit” Vau Dejës, Telefon/Faks 00355 2612 0006 , e-mail: info@vaudejes.gov.al

SEKRETAR I KËSHILLIT

Ardian Celepija